



Trafikimi dhe prostitucioni në vend dhe rajon

Muhamet Lama¹

Abstrakt

Përveq atlasëve të ndryshëm gjeografik ku përmendet Iliria dhe ndonjë shënimi të rrallë nuk kemi ndonjë njohuri lidhur me këtë dukuri tek Ilirët e më vonë tek shqiptarët e sotëm në tërë etnikumin e tyre. Por sipas disa të dhënave indirekte del se edhe në Iliri ishte i pranishëm institucioni i robërisë të cilët duhej të punonin token në kohë paqeje ndersa në kohë lufte vëheshin nën urdhërat e të zotit për mbrojtjen e vendit. Në këtë „shkretirë shkencore” duket i drejtë mendimi se edhe në Iliri ka patur „liri seksuale” dhe se rrugët „Via Egnacia” kanë qenë përplot hane e bujtina ku musafirëve iu është shërbyer me femra që në gjuhën popullore njihen si femra të përdala. Dhe duke patur parasysh se kanë ekzistuar këto hane dhe bujtina (ato ndertoheshin në udhëkryqe, afër rrugëve kryesore njëjtë si sot ekzistimi i moteleve dhe hoteleve) mendojmë se edhe në këtë hapësirë ka ekzistuar dukuria e prostitucionit.

Fjalët Kyçe: trafikimi, prostitucioni, rajon, histori, fille

Trafikimi në vend dhe rajon

Megjithatë, kur është fjala për shqiptarët disa studiues dukurinë që po e shtjellojmë e kundrojnë nga këndvështrime të ndryshme dhe me konotacione tejet negative. Ata çështjen e krimit të organizuar të shqiptarët e posaqerisht trafikimin e qenjeve njerzore, prostitucionin dhe kontrabandimin me njerëz ia atribuojnë „gjenit shqiptar” i bazuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Pra këta autor Kanunin e Lekë Dukagjinit e konsiderojnë si „bibël të mafias shqiptare” ndersa të tjerët këtë dukuri e shikojnë si pjesë të „bisnesit global” të krimit të organizuar ku janë të inkuadruar grupe kriminale nga anë të ndryshme të globit². Duke mos u venë në mbrojtje të Kanunit citojmë studiuesën Barbara Hanel e cila shkruan se „ Kanuni i Lekë Dukagjinit , Ligji i Zakoneve Shqiptare të vjetra me shekuj përfaqson një sistem të vlerave që përmban rregulla detale për sjelljen e „duhur” si dhe gjykim të kundërvajtësve kode të sjelljes për të parandaluar joharmoninë dhe për të pararenduar rendin në fisin e tyre”³. Për të parë të vertetën lidhur me KLD duhet vetem qasje e drejtë dhe jo tendencioze dhe durim në studimin e tij. Nëse lihet anash njëanshmëria dhe merret parasysh nxjerrja e fakteve atëherë shihet qartë se askund nuk

¹ PhD, Kandidat, Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri, Profesor në Kolegji Biznesi, Gjakovë

² Sokoli L., vepra e cituar f.54

³ Hanel B., (2004), Bazat e Menagjimit për Mbikqyrjen dhe Menagjimin Policor- Shkolla e Sherbimit Policor-Vushtrri, f. 68



mund të gjesh një shkronjë a rrjesht i cili pordhosë figurën e gruas shqiptare. Kanuni i Lekë Dukagjinit ka disa paragrafe ku qenja e gruas mbrohet edhe me armë. Pragrafi 835 thotë: „, Prita do të fillojë mbë burra e jo mbë gra, fmi, mbë shtëpi e mbë bagëti...” përndryshe „...do hijë pushka shpi mbë shpi, mandej fis mbë fis, katund me katund e së mbrami flamur me flamur”. Paragrafi 767 pika a) i KLD thotë: „, për të hikun të grave bjen në gjak e 500 grosh do t’i jap katundit për giobë”. Gruaja shqiptare sipas KLD është e mbrojtur, edhe nese e vret dikend nuk bje në gjak thuhet në kreun e 28 të tij. Sipas kreut (Nye) 31 nëse nusja e cila martohet nuk është „si duhet” (e virgjër) burri ka të drejtë t’ia presë thekun a flokun a me lshue por nëse burri pajtohet me gjendjen e saj Kanuni ia lejon jetesën me te por asesi ta shes ose ta vras. Studiues që nuk e kanë lexuar kurrë Kanunin dhunenë ndaj femrës në familjen shqiptare e bazojnë pikerisht në normat e tij por realiteti qendron ndryshe. Pragrafi 61 (a) i KLD thotë „Burri nuk ka tagër mbi jetën e gruas” ; c) me e vra i biri t’amën bje n’ gjak me prindërit e t’amës”; d) me e rrahë me plyrë në gjak, a me e vra gruen e burrit dora e huaj nderen ia kerkon burri, varrën e gjakun prindja”; e) me rrahë kunetija gruan e burrit prindja e grues ia lypin nderen në mos i raftë mbrapa i shoqi”. Pra, siq po shihet KLD në mënyrë institucionale e mbron gruan nga dhuna që mund të ushtrohet qoftë edhe nga djali i saj, burri apo kunati dhe asnjeri nga këta nuk ka të drejtë të ushtroj dhunë mbi te.

Gruaja sipas KLD ka të drejtë të ndermjetësoj mes personave në ngatresë të atyperatyshme dhe fjala e saj duhet të respektohet, pushka duhet të ndalet.⁴ Dhunimi i gruas apo grabitja e saj konsiderohet si nder i marrur i burrit të saj dhe ai nder i nëpërkëmbur kërkon hakmarrje sipas paragrafit 601 dhe 597 të KLD por mund ta falë dhunuesin fisnikisht dhe pa demshpërbllim konform paragrafit 598 të KLD.

Është interesant se gjatë periudhës së sundimit të mbretit Zog në Shqipëri prostitucioni ishte present dhe i njejtë bazohej në një rregullore të Sarajevës (BeH). Kjo rregullore u përmirësua dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr.196 të datës 10 shkurt 1922 shëndrrohet në ligj dhe me këtë ligj legalizohet prostitucioni në Shqipëri. Pas këtij viti në Shqipëri hapen shumë shtëpi publike në shumë qytete të Shqiperisë ku ushtrohej prostitucioni ndersa drejtuesi i shtëpisë publike detyrohej që ¼ e të ardhurave t’ia jepte prostitutës. Me këtë ligj u ndalua prostitucioni i rrugës. Me këtë ligj ishin krijuar mundësi për ndihma prostitutave që hiqnin dorë vullnertarisht dhe për ato prostitute të huaja që deshironin të ktheheshin në vednin e tyre u paguheshin shpenzimet e rrugës. Ndersa per ato që ziheshin duke prostituuar ilegalisht denoheshin me 10-100 franga ari dhe deri në dy vjet burg.⁵

Gjatë periudhës së regjimit Komunist në Shqipëri askush nuk guxone të fliste për trafikim të qenjeve njerzore, disa shtëpi publike në Tiranë të cilat kanë ekzistuar shin rrafshuar me tokë nga rexhimi komunist por sipas të dhënave që posedojmë del se nuk ishte ç’rrenjosur edhe prostitucioni. Sipas të dhënave del se citojmë : „, Shumë qeveritar shqiptar kishin kthyer kohen e „çengive”(vajzat e haremeve kryesisht valltare) me një

⁴ Gjeqovi Sh., (1999), Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë ,f. 123

⁵ Sokoli L., Studime Sociologjike veper e cituar, f. 66



dallim që aty nuk rekrutoheshin më cigane si përpara. Ndonëse me një diskrecion të thellë pushtetarët shqiptar i kishin haremët e tyre , në të cilat rekrutoheshin në mënyrë sistematike vajza të reja dhe të bukura nga pjesë të ndryshme të vendit”⁶ Në këtë tekst kjo autore jep të dhena për ekzistencën e dy shtepive publike të cilat funksiononin në Tiranë (koha e Enver Hoxhës) por që askush nuk guxonte t’i përmendte. Në këto shtëpi defrehashin drejtor ndërmarrjesh të mëdha, oficer të Sigurimit dhe ushtarake. Sipas autorës vajzat që i shërbenin elitës politike, ushtarake dhe policore në Tiranë gëzonin privilegje të mëdha por nuk paguheshin me para. Ndërsa prostitutat e ndërmarrjeve ushtronin këtë profesion për kënaqësi por edhe paguheshin me para. Në këtë mes përmenden edhe prostitutat të grupit etnik rom.

Në vitet e 90-ta ndodhen ndryshime të mëdha, u thye Muri i Berlinit, sistemet socialiste ranë njeri pas tjetrit, ekonomia e ketyre vendeve u shkatrrua plotësisht, dhe e vetmja shprese ishte ikja nga vendi dhe kalimi në vendet kapitaliste perendimore. Pra, ndryshimet që ndodhën në skenën politike ndërkombetare ndikuan dhe motivuan dyndjet e popullatës civile e cila diku largohet për shkaqe ekonomike (rasti i Shqipërisë 2 korrik 1990 –Hyrja në Ambasada të Huaja në Tiranë) diku na shkaqe sigurie (fillimi i luftrave të pergjakshme ish-jugosllavi). Sidoqë të jetë pa numëruar shkaqet një për një, njerëz të deshpruar largoheshin nga vendi i origjinës sepse kishin mbetur pa shpresë, pa punë dhe me bindje se perendimi është „Toka e Premtuar” ku duhet të shkohet me çdo kusht.

Në një situatë të tillë u gjend edhe ish-Jugosllavia e viteve të 90-ta e cila nën regjimin mesjetar të Millosheviqit , Millosheviqi dhe regjimi i tij mbylli çdo perspective dhe filloj realizimin e endrës Qubrilloviqiane për krijimin e Serbisë së Madhe që ishte plasuar nën vëllin e instruksioneve shkencore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë. I nxitur nga nacionalizmi mesjetar regjimi serb nisi luftrat dhe në keto luftra forcat serbe militare dhe paramilitare kryen masakra të papara në Kroaci BeH dhe në Kosovë. Dhe me bekimin e qarqeve të ndryshme mbrenda dhe jashtë saj shkeli kushtetutën e vendit dhe shkatroj autonominë e KSA e Kosovës. Kuvendi, Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e saj u shperndanë me dhunë policore dhe ushtarake. Mbas shkatrrimit institucional të Kosovës Serbia filloj një fushatë e egër ushtarake kundër viseve tjera të Jugosllavisë ndërsa rininë kosovare e deshironte ta dergoj në frontet e luftës në Slloveni, Kroaci dhe në BeH më vonë. Alternativa Kosovare nuk pranoi të jetë pjesë e skenarit të krijimit të „Serbisë së Madhe” dhe për këtë iu nënshtrua një presioni të paparë politik dhe ushtarak-policor. Për të mos i shërbyer kësaj ushtrie pushtuese serbe rinia e Kosovës filloj të braktisë vendin dhe të kërkoj shpëtim në vendet e Europës Perendimore. Ky migrim filloj në masë të madhe mes viteve 1990-97 përmes rrugëve legale dhe ilegale me „ndihmën” dhe nën mbikqyrjen e trafikantëve dhe kontrabandistëve të ndryshëm të cilët për këtë „ndihmë” paguanin nga 2000 deri në 20.000 marka gjermane për kokë. Paratë u paguheshin në dorë trafikantëve të cilët ishin lidhur me zyrtar të policisë dhe gjyqësisë të instaluar në Kosovë, posaqërisht zyrtarve policor të cilët punonin në sektorin e dhënjes së pasaportave, sektorin e policisë kufitare, doganierve etj. Itinerari që ata ndiqnin për largim

⁶ Gërxfhalii S., (2003), Trafikimi dhe Prostitucini në Kosovë, Prishtinë, f. 33



ishin rrugët tokësore, detare dhe ajrore. Për transportimin e tyre jashtë vendit më së tepërmi përdorej transporti rrugor ku ishin të kyqura disa kompani vendore kosovare transportuese. Itinerari që ata ndiqnin ishte nga drejtimi Pejë-Mitrovicë-Rashkë-Beograd-Suboticë-Segedin (Hungari) dhe vazhdonin për në Gjermani, Zvicër a ndonjë vend tjetër europian. Rruga tjetër autobobilistike ishte Prishtinë-Podujevë-Merdare-autostada e Nish-Beograd- Kelebi (kufiri mes Vojvodinës dhe Hungarisë) dhe vazhdonte për në vendet europiane. Rruga e tretë ishte Prishtinë-Pejë-Rozhajë-Podgorcë-Debeli-Brijeg-autostrada e Adriatikut (Kroaci)-Slloveni –Itali e shkonte tej në Europë. Nga Podgorica herë herë vazhdohej rruga për në Shqipëri përmes Tuzit duke kaluar me barka (vendasit i quajjnë Sule) natën e ditën përmes Tuzit- Kodra Budanit- Nënhelm-(Mali i Zi) Liqeni i Shkodrës-Shkodër-Tiranë-Durrës-Itali. Një rrugë tjetër vazhdohej nga Kosova duke kaluar kufirin e Kosovës në Kullë- Rozhajë-Podgoricë-Ulqin-Sukubinë- (Anë e Malit, Mali i Zi)-Rrushkull- (Shqipëri)-Shkodër-Tiranë-Durrës-Itali. Edhe një rrugë përdorej por më rrallë në drejtimin Prishtinë-Shkup-Strugë- Qafë-Thanë-Tiranë (përmes aeroportit Nënë Tereza-Itali) ose Qafë Thanë-Vlorë-Brindisi (Itali) transport përmes Grykës së Otrontos me gomone (barka të shpejta motorike prej gome). Kjo dhunë e ushtruar ndaj rinisë kosovare në veqanti pas viteve të 90 kishte për qëllim realizimin strategjik –spastrimin etnik gjë që ndikoj në rritjen kontrabandimit me njerëz dhe trafikimit të qenjeve njerzore⁷.

Meqë metodat e presionit dhe dhunës policore-ushtarake nuk përmbushën synimet e politikës së Millosheviqit (deshtimi i saj ushtarak në Kroaci dhe pas marreveshtjes së Dejtonit për BeH), ajo (Serbia) filloj operacionet ushtarake kundër forcave të sapokrijuara të UÇK-së dhe popullatës civile e cila ishte bazë e logjistikës së saj. Serbia e mbarsur me planet hegjemoniste duke u bazuar në epërsinë ushtarake të saj filloj realizimin e projekteve qubrilloviqiane për spastrimin etnik duke e aktivizuar operacinin famëkeq „Patkoi” i cili filloj me dëbimin e popullatës civile (shqiptarë, dhe të tjerë) nga Kosova. Gjatë realizimit të këtij operacioni famëkeq (dhjetor-98- prill 99) ushtria dhe policia serbe filloj spastrimin etnik të Kosovës, duke kryer dhunime sistematike të grave dhe vajzave shqiptare në „kampe dhunimi”⁸ duke i shëndrruar në skllave seksi⁹. Çmenduria e tyre kishte arritur aq larg sa që kishin krijuar një himn „motivues” që kendonin ushtarët para „operacioneve ushtarake” sipas së cilit kërkohej të tregoheshin heronj edhe para fëmijëve

⁷ The Kvinna till Kvinna Foundation, 2001, Getting it Right? Paraqet shqetsimin e tyre për Bordelet E shumta që funksiononin në Kosovë gjatë periudhës së Misionit Verifikues të OSBE në shtator 1998 dhe shqetsimin e tyre lidhur me trafikimin e qenjve njerzore, f. 20

⁸ Kosovo-Gender Bases Violence Against Kosovar Albanians. Botim I Human Rights Ëatch. Për hapje të kampeve të dhunimit nga forcat serbe në një prononcim në media me datën 13 prill 1999 kishte reagu edhe sekretari britanik i punëve të jashtme z. Robin Cook dhe zedhensi i Pentagonit z. Kenneth Bacon, Raporti I Human Rights Ëatch-Kosovo-International and National Protections against Rape and other forms of sexual violence , Raporti I Human Rights Ëatch –Kosovo –The aftermath:Ongoing issues facing Kosovar Albanians Women Skender Blakaj, Zejnullah Rrahmani, Kosova Facts that Ëon’t Keep Silent, ATV Media Company Prishtinë 2007 faqe 160 -161

⁹ Assessment Report on Sexual Violence in Kosovo UNPA 28 May 1999 By D.Serrano Fitamant



dhe grave të anmiqve”¹⁰ Dhunimi I grave dhe fëmijëve kishte qëllim të dyfishtë: e para shfrytëzimi seksual nga ushtarët serbë dhe forcat paramilitare dhe e dyta për të ndikuar në uljen e moralit të popujve anmiq (kroat, boshnjak dhe shqiptar) dhe forcave mbrojtëse të tyre që luftonin kundër agresionit serb.

Megjithë epërsinë ushtarake Serbia dështoj në fushën e luftës edhe në Kosovë (nga forcat vendore Kosovare –UÇK- e ndihmuar edhe nga intervenimi 78 ditësh i NATO-s) por la pas shumë varre masive, shumë persona të zhdukur, shumë gra dhe vajza të dhunuara¹¹, ekonominë dhe infrastrukturën të shkatërruar, shumë fshatra dhe qytete të djegura.

Pas luftës 1998-1999 në Kosovë bazuar në rezolutën 1244 të OKB-së u vendos misioni civil (i OKB-së) dhe ushtarak (Kosova Force-KFOR) në tërë territorin e saj. Praktikisht, përveq KFOR-it pushteti i UNMIK-ut nuk (për arsye politike) ka funksionuar në pjesen Veriore të Kosovës. Kjo „Eldorado” e tipit të veçantë e Kosovës gjindet pa pushtet efektiv të qeverisë së Kosovës dhe „qeveriset” nga grupe kriminale të cilët merren me krim të organizuar (tregtia me cigare, naftë e benzin, alkool, trafikimi me qenje njerzore, prostitucioni dhe kontrabandimi). Duhet pranuar se kjo pjesë e Kosovës gjindet jashtë kontrollit legal (sistemi doganor dhe kufitar është tejet i brishtë) të gjitha aktivitetet kriminale (trafikimi me qenje njerzore, kontrabandimi i mallit, drogës, armëve, njerzve) janë prezente në këtë pjesë të Kosovës¹² duke ndjekur rrugën Mitrovica e Veriut (Kosovë)-Podgoricë (Malit të Zi) - Bar-Bari (Itali) ose duke ndjekur rrugën e luginës së Ibrit Rashkë- Shabac(Serbi)- Bosnjë e Hercegovinë- Kroaci drejt vendeve të Europës Perendimore. Duke patur parasysh këtë gjendje në këtë pjesë të Kosovës (Mitrovica e Veriut) e cila i ngjan një zone me „status special” e ndihmuar nga Qeveria Serbe dhe nga vet UNMIK-u (me neglizhencen e vet) që në mënyre indirekte ndihmojnë në organizim dhe ushtrimin e veprimtarive kundërligjore.¹³ Pra, situata e paqartë në këtë pjesë të Kosovës sa i përket ushtrimit të autoritetit qendror të UNMIK-ut ka ndikuar në rritjen dhe shendrrimin e kesaj pjese në „oazë” të Krimin të organizuar ku grupe kriminale të vendeve të ish-Jugosllavisë të të gjitha nacionaliteteve bashkohen bashkë dhe veprojnë në mënyrë gjysmë legale. E gjithë kjo anomali ndodh për disa arsye:

- e para, se UNMIK-u asnjëherë nuk është marrë seriozisht me „çështjen e Mitrovicës”

- e dyta, se Qeveria e Kosovës nuk kishte kompetenca të ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me „çështjen Mitrovica” dhe e

- e treta, se Qeveria e Serbisë e përdor këtë „Eldorado” të Kosovës për qëllime ekonomike dhe politike.

¹⁰ Ky himn kendohej nga forcat e Legia-s të cilat vepronin nën petkun e MUP-it serb para se të fillonin operacionet. Ky himn dhe pamjet e tyre janë ritransmetuar në programin televiziv të RTK-së të një programi të B92 nga Beogradi, emisioni i orës 20:00 i datës 17.08.2007).

¹¹ Liaison Office of Sweden in Prishtina, Kosovo gender analysis, faqe 12, 17 May 2004

¹² Të gjitha grupet kriminale pa marrë parasysh kombësinë (serb, shqiptar, turq, kroat, boshnjak, rus, ukrainas, moldov etj) veprojnë bashkë

¹³ Komisioni Europian ,Bruksel, 9 nëntor 2005 SEC (2005) 1423 faqe 58 (Raporti i Progresit të Kosovës)



Përveq qasjes politike në luftimin e krimit të organizuar që mbisundon në vendet e ballkanit perëndimor në përgjithësi (përfshirë edhe Kosovën) e që ndikojnë në paqen dhe stabilitetin politik dhe ekonomik dhe në përfshirjen e tij në intergrimet euro-atlantike janë edhe një mori faktorësh tjerë që ndikojnë negativisht në luftimin dhe parandalimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veqanti siq janë:

- Levizjet e madha të popullatës civile si pasojë e luftës civile në Jugosllavi mbreda përbrenda vendit dhe jashtë saj
- Pasojat që la pas konflikti i armatosur (dhunime, shkatrrime të infrastrukturës, fabrikave, ku njerzit humben vendet e tyre të punës gjë që shkatëroj një gjendje të pa shpresë)
- Mungesa e përvojës së organeve për Zbtimin e Ligjit në luftimin e krimit të organizuar i cili u paraqit pas viteve 1990.
- Mungesa e infrastrukturës të nevojshme ligjore
- Mungesa e kuadrit të kualifikuar (në polici) i cili duhet të ballafaqohet me luftimin e këtij fenomeni mjaft të rezikshëm (krimit të organizuar)
- Mungesa e një bashkpunimi ndërshtetror mes shtetëve të sapokrijuara të ish-jugosllavisë në luftimin e krimit të organizuar
- Mungesa e një bashkpunimi mes faktorit vendor dhe ndërkombëtar (në Kosovë dhe BeH, ngase këta dy faktor janë përjashtues e jo bashkëpunues) në marrjen e masave për luftimin e krimit të organizuar
- Mungesa e një qasjeje të drejtë profesionale-shkencore kundrejt krimit të organizuar.
- Mungesa e një administrate të mirëfilltë (administrata e vjetër u shpërbë, ndërsa u krijua një administratë e re pa kriterë) dhe ekzistimi i sistemit paralel në Kosovë (për lëshimin e dokumenteve lejeve të njohtimit, pasaportave, patent shoferit, Çertifikatave të shtetësisë, të lindjes etj)¹⁴

Pra, Kosova e sapodalë nga lufta, me një administratë të re dhe pa përvojë, me një polici të re të rekrutuar nga UNMIK-u (sepse MPB të Kosovës u shpërbë nga UNMIK-u), me një kuadër civil dhe policor të OKB-së shumëetnik (nga vende të ndryshme të botës) në disa raste joprofesional (polici i patrollës ose i trafikut në vendin e tij, tani bëhet komandant Rajoni ose shef i njesitit të hetimeve për krime të rënda), të ndikuar nga qeveritë e tyre (motivime të ndryshme, varej nga cili shtet vjen), me disa sisteme (vendor, i UNMIK-ut dhe sistemi paralel serb) ku secili kishte „kompetencë” në lëshimin e dokumenteve të identitetit e kjo ishte si rezultat i një statusi të pazgjdhur politik¹⁵, i një pushteti dualist qeverises, i një sistemi të brishtë të sigurisë (me mbi 40 sherbime sekrete që funksionojnë në Kosovë), me një popullatë e cila sa ishte kthyer nga egzodi dhe nuk

¹⁴ Gjatë luftës 1998/1999 forcat serbe kishin plaqkitur popullatën e cila largohej nga Kosova drejt vendeve fqinje dhe njekohesisht në dalje të Kosovës iu kishin marrë dhe asgjësuar edhe dokumentet e identitetit (leje njohtimi, pasaporta dhe patent shoferi)

¹⁵ Bisedimet 120 ditëshe mes delegacioneve të Prishtinës dhe Beogradit kanë përfundur me 10 dhjetor 2007 pa sukses. Këto bisedime janë udhëhequr dhe ndermjetsuar nga treshja nderkombëtare Ishinger (BE), Wisner (SHBA), Hartcenko (Rusi).



kishte kulm mbi kokë, pa të ardhura dhe pa bukë ishin disa nga faktorët determinues që ndihmuan në mënyrë indirekte aktivitetet kundërligjore të trafikantëve dhe kontrabandistëve të të gjitha ngjyrave.

Fillet e prostitucionit ndër shqiptar, Shqipëri - Kosovë

Fenomeni i prostitucionit në shoqërinë shqiptare, para dhe pas formimit të shtetit kombëtar, nuk është bërë objekt trajtimi nga studiues dhe, si pasojë, fondi i studimeve për këtë temë është thuajse i zbrazët. Në mungesë të burimeve të mirëfillta, si burim informimi mbeten dokumentet zyrtare. Dokumentet e Arkivit të Shtetit dëshmojnë se në Shqipëri, prostitucioni i mirëfilltë, por ilegal, u shfaq në fund të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX. Ai u shfaq duke filluar nga viti 1910, në qytetin e Shkodrës dhe, sidomos pas vitit 1920, në të gjitha qytete e mëdha të vendit.¹⁶ Edhe reagimi i parë zyrtar rreth këtij fenomeni përkon thuajse me fillimin e vetë shtetit shqiptar. Për disiplinimin e prostitucionit, shteti vendosi pa ndonjë hezitim të madh legalizimin. Ai fillimisht huazoi rregulloren e prostitucionit të Sarajevës. Më pas vijuan një varg analizash, të bazuara mbi raporte komisionesh të posaçme mbi prostitucionin, në organet vendore të Korçës, Durrësit, Elbasanit etj. Prej tyre u arrit në vendimet për të parat shtëpi publike në Shqipëri. Këto trajtesa lokale u pasuan nga rregullorja e re e prostitucionit, miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendim nr. 196, datë 10 shkurt 1922. pas miratimit në Parlament, kjo rregullore u shëndrrua në ligj.¹⁷ Në bazë të kësaj rregullore të aprovuar nga Parlamenti i atëhershëm Shqiptar, ky “biznes” është ligjësuar, dhe de facto dhe de juro, nuk mund të ndërhynte askush në zhdukjen e kësaj dukuri ç’moralizuese të popullatës shqiptare në tërësi. Edhe përmes dokumenteve të marra nga Arkivi i Shtetit Shqiptar, dëshmohet se prostitucioni profesionist ka ekzistuar ndër shqiptar edhe para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në një letër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë drejtuar Mëkëmbësish Mbretërore të Përgjithshme (9 janar 1942), thuhet se shtëpia publike e vendosur në Vlorë, në rrugën “Viktorio Emanuel”, nr. 40, “rezulton e hapur që prej vitit 1919”. Por ushtrimi i prostitucionit është vërtetuar në një hotel në Shkodër, qysh në vitin 1910.¹⁸ Sipas këtij dokumenti, mund të themi se zyrtarisht prostitucioni në Shqipëri është njohur edhe para njohjes së Shtetit Shqiptar si shtet të pavarur. Fakte sikurse këto provojnë ekzistencën edhe në Shqipëri të ushtrimit të prostitucionit nga gra e vajza profesioniste apo të tjerë që e ushtrojnë atë “partë time” krahas atyre që kanë hyrë në tregun e mistershëm të prostitucionit të vendeve të tjera.¹⁹ Pas viteve 1990, prostitucioni është favorizuar nga papunësia dhe, përgjithësisht, nga gjendja e vështirë ekonomike, si

¹⁶ Musaj F., (2002), Gruaja në Shqipëri 1912-1939, Tiranë, f. 260-61.

¹⁷ Fletorja zyrtare, nr. 30, Gusht, 1922, fq. 4.

¹⁸ Musaj F., (2002), Gruaja në Shqipëri 1912-1939, Tiranë, f. 260-274

¹⁹ Revista Spektër, Prostitucioni, holokausti Shqiptar, nr. 17, 19 prill 2003, fq. 19-21.



dhe etja e shfrenuar për para e fitim. Nga anketimet e kryera del se opinioni publik shqiptar është në masën 67.7% dakord me mendimin se varfëria është një ndër shkaqet e trafikimit të femrave dhe ushtrimit të prostitucionit.²⁰ Ndryshe nga shumica e vendeve të tjera, në Shqipëri, deri në vitet '90-t prostitucioni, sikurse droga, homoseksualizmi etj., nuk njihet si fenomen. Ky "përrjashtim" lidhet, së pari, me jetën tradicionale shqiptare dhe të drejtën dokesore dhe, së dyti, me faktin se regjimi i hekurit komunist nuk lejoi përhapjen e tij.²¹ Këtu duhet shtuar ndoshta faktorin më relevant dhe më mbizotërues në këtë drejtim, fenë islame, e cila ka qenë, është dhe do të jetë mbrojtje më efektive krahas çdo institucioni edukativ arsimor.

Sa i përket Kosovës pjesë e këtij biznesi, nuk posedojë ndonjë dokument zyrtar se kur ka filluar ky zanat në Kosovë mirëpo, në fakt, për hir të së vërtetës duhet të behëm reale dhe të pranoj, se atë që nuk posedojë unë nuk mund të them se nuk ekziston, së paku kështu është realiteti. Në Kosovë është folur e përfolura për këtë zanat si para luftës së fundit, ashtu edhe pas luftës së fundit, gjithandej Kosovës janë organizuar seminare e tubime informative për këtë epidemi mirëpo, se nga kur rezulton kjo, nuk posedojë ndonjë dokument zyrtar i cili do të argumenton më bindshëm këtë "biznes" në Kosovë. "Në Kosovë ka prostitucion dhe ka edhe klientë", u tha me plot gojën nga aktivistë ndërkombëtarë e vendorë për të drejtat e njeriut. Qindra e ndoshta me mijëra vajza të reja po kalojnë në Kosovë kalvarin e "zanatit më të vjetër në botë". Moshë mesatare e tyre, sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), është 23 vjet, ndërsa rrugëtimi i pjesës dërmuese të tyre është i ngjashëm me të gjitha rrugëtimet e shoqeve të tyre nëpër botë, vetëm se në Ballkan duket që shkalla e "egërsisë" së bosëve e makrove është më e madhe. Policia e Kosovës, që drejtohet nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, ka zbuluar disa shtëpi publike nëpër qendra të ndryshme të Kosovës. Janë arrestuar, disa dhjetëra persona, ndërsa mbi 100 femra janë riatdhesuar me ndihmën e IOM-it. Pjesa më e madhe e tyre vjen nga vendet e varfra të ish bllokut socialist, ndërsa rrëfimet janë të ngjashme. Shumë prej tyre që janë kontrabanduar në Kosovë nuk kanë pasur as idenë më të përafërt se do të detyrohen ta ushtrojnë prostitucionin. Ato janë nisur pas premtimeve se do të gjejnë punë në Kosovë, sigurisht të mashtruara nga prania e madhe ndërkombëtare. Migrimi, që shënon edhe fillimin e ferrit të jetës së tyre, sipas studimeve të IOM-it, nxitet nga luftërat dhe shkatërrimet ekologjike, por më së shumti nga kushtet e rënda ekonomike. Femrat që arrijnë në Kosovë më së shumti "rekrutohen" nga Moldavia, Ukraina, Rumania e Bullgaria. Disa syresh prapa vetes lënë edhe familjet dhe fëmijët e tyre.²² Tashmë në Kosovë më pothuajse nuk konsiderohen lajme rastet kur policia ndërhyt në lokale të ndryshme dhe gjen se janë punkte të prostitucionit. Është indikativë gjithsesi që rastet më të shpeshta, policia i gjen në qytete tradicionale si Prizreni, Prishtina a Gjilani. Por, Kosova nuk është e vetmuar në këtë shëmti. Sipas një raporti më të fundit të Stejt departamentit, Shqipëria vazhdon të jetë vend ku "problem mbetet puna e

²⁰ Sokoli L., (2006), Analiza sociologjike, Tiranë, f. 35

²¹ Sokoli L., (2006), Analiza sociologjike, Tiranë, f. 35

²² <http://www.aimpress.ch/dyn/alba/archive/data/200012/01224-003-alba-pri.htm>



fëmijëve të mitur, trafikimi i tyre dhe i grave, të cilat nuk janë të mbrojtura”. Po ashtu, muajt e fundit është raportuar shumë shpesh për punkte të shumta të prostitucionit në Maqedoni, veçmas në zonat e banuara me shqiptarë, ku kanë ndodhur edhe raste të vrasjeve të disa prostitutave.²³ Analist të ndryshëm kanë mbledh fakte rreth kësaj dukurie në Kosovën e pas luftës. Sipas një studimi të nxjerr nga Raufet Xavier & Quere Stefane në studimin e tyre “Mafia shqiptare një rrezik për Evropën” rreth prostitucionit në Kosovë kanë nxjerrur këtë përfundim, “Edhe prania e KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë, sipas tyre, vetëm e fuqizon mafian, pikërisht se kjo prani ka ndikuar në ngritjen e shkallës së prostitucionit, pra të nivelit të të ardhurave të mafiozve shqiptarë. Madje sipas tyre Raufet & Quere misioni i tyre në Kosovë është i paracaktuar të dështojë jo vetëm se në të ka përzjerje kombësish, një mandat i paqartë dhe kontradiktor, burime të ndryshme autoriteti, shpesh konfliktual, por ushtarakët e KFOR-it u thonë (pikërisht në shtrat), prostitutave (pra mafiozeve), të fshehta të rrezikshme. Pra, drejtpërdrejt apo tërthorazi, këta autor të paskrupullt i thonë botës se prostitucioni dhe droga (dy gjymtyrët e mafias shqiptare), duhet të jenë kritere bazë për të vendosur për integrimin e Shqipërisë apo statusin e Kosovës.

Referenca

- Hanel B., (2004), Bazat e Menagjimit për Mbikqyrjen dhe Menagjimin Policor- Shkolla e Sherbimit Policor- Vushtri, f. 68
- Gjeqovi Sh., (1999), Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë ,f. 123
- Sokoli L., Studime Sociologjike veper e cituar, f. 66
- Gërxhaliu S., (2003), Trafikimi dhe Prostitucioni në Kosovë, Prishtinë, f. 33
- The Kvinna till Kvinna Foundation, 2001, Getting it Right? Paraqet shqetsimin e tyre për Bordelet E shumta që funksiononin në Kosovë gjatë periudhës së Misionit Verifikues të OSBE në shtator 1998 dhe shqetsimin e tyre lidhur me trafikimin e qenjve njerzore, f. 20
- Kosovo-Gender Bases Violence Against Kosovar Albanians.Botim I Human Rights Ëatch.Për hapje të kampeve të dhunimit nga forcat serbe në një prononcim në media me datën 13 prill 1999 kishte reaguar edhe sekretari britanik i punëve të jashtme z. Robin Cook dhe zedhensi i Pentagonit z. Kenneth Bacon, Raporti I Human Rights Ëatch-Kosovo-International and National Protections against Rape and other forms of sexual violence , Raporti I Human Rights Ëatch –Kosovo –The aftermath:Ongoing issues facing Kosovar Albanians Women Skender Blakaj, Zejnullah Rrahmani, Kosova Facts that Ëon’t Keep Silent, ATV Media Company Prishtinë 2007 faqe 160 -161
- Assessment Report on Sexsual Violence in Kosovo UNPA 28 May 1999 By D.Serrano Fitamant
- Liaison Office of Sweden in Prishtina, Kosovo gender analysis, faqe 12, 17 May 2004
- Musaj F., (2002), Gruaja në Shqipëri 1912-1939, Tiranë, f. 260-61.
- Musaj F., (2002), Gruaja në Shqipëri 1912-1939, Tiranë, f. 260-274

²³ Krasniqit M., Evropa e Lirë, 4 Prill 2003.



Revista Spektër, Prostitucioni, holokausti Shqiptar, nr. 17, 19 prill 2003, fq. 19-21.

Sokoli L., (2006), Analiza sociologjike, Tiranë, f. 35

Sokoli L., (2006), Analiza sociologjike, Tiranë, f. 35

<http://www.aimpress.ch/dyn/alba/archive/data/200012/01224-003-alba-pri.htm>

Krasniqit M., Evropa e Lirë, 4 Prill 2003.